



**GRATË DHE
BURRAT
NË KOSOVË**

**WOMEN AND
MEN
IN KOSOVO**



Drejtor botimi: Avni Kastrati
Grupi i punës: Sanije Uka, Udhëheqëse
Anëtar: Hamide Kunushevci, Ajshe Avdiu, Nazife
Pushka, Kadri Sojeva.

Për kontributin e dhënë falenderohen, bashkëpunorët e
Statistikave të Suedisë: Ingrid Floren, Christine
Uhlander Lindblom dhe Milva Ekonomi

Director of Publication: Avni Kastrati
Working team: Sanije Uka, Chief
Member: Hamide Kunushevci, Ajshe Avdiu, Nazife
Pushka, Kadri Sojeva,

For their contribution thank goes to Ingrid Floren,
Christine Uhlander Lindblom and Milva Ekonomi

Botuesi: Enti i Statistikës së Kosovës
Data e botimit: Nëntor 2008
Riprodhimi autorizohet nëse indikohet burimi.
Informata të shumta janë disponibël në internet, ku
mund të qaseni përmes web-faqes së ESK-së:
www.ks-gov.net/esk

Publisher: Statistical Office of Kosovo
Publication date: November 2008
Reproduction is authorised provided the source is ac-
knowledged.
A great deal of information is available on Internet is
available on Internet, which can be accessed on the
SOK Website: www.ks-gov.net/esk

Hyrje

Publikim i tretë i serisë “Gratë dhe burrat në Kosovë”, u vjen përdoruesve si një botim me të dhëna statistikore më aftagjata dhe me analiza të shkurtra, për të ndihmuar në perceptimin e situatës gjinore në vend. Enti i Statistikës, përdori të gjitha burimet e të dhënave të disponueshme, të cilat ofronin një informacion statistikor të plotë për të dhënë situatën gjinore sipas sektoreve të jetës ekonomike dhe sociale në vend. Ky publikim u bë i mundur në saj të bashkëpunimit të Entit të Statistikës së Kosovës me Zyrën për Barazi Gjinore, pranë Zyrës së Kryeministrit.

Falenderime të vecanta i shkojnë Zyrës Qëndrore të Statistikave Suedeze, për asistencën teknike të ofruar si dhe Agjencisë Suedeze për Zhvillim Ndërkombëtar (SIDA) që mundësoi finalizimin e këtij publikimi. Duke Ju uruar përdorim të mbarë.

Kryeshefi Ekzekutiv

Avni Kastrati

Introduction

This third edition of the series of “Women and Men” in Kosovo is presented today to you in order to help your perception on the gender situation through time series of statistical data and short analysis. Statistical Office of Kosovo used all the available data sources which offered complete statistical information and put them in such an order to facilitate the portrayal of the gender situation in the economic and social areas.

This publication is the result of a close cooperation of the Statistical Office of Kosovo with the Office of Gender Equality at the Prime Minister Office.

Special acknowledgement goes to Statistics Sweden for offering its technical assistance, as well as to the Swedish Agency for International Development (SIDA) which made possible the finalization of this publication.

Wishing this to be a useful thing for you,

General Director,

Disa fakte të rëndësishme

Gratë dhe burrat duhet të jenë të dallueshëm edhe në informacionin statistikor, ndaj disa të dhëna shpërndahen sipas gjinisë në publikimet e realizuara nga Enti i Statistikës së Kosovës.

- Popullsia kosovare është në moshë të re, popullsia deri në 18 vjeç përbën 46% të popullsisë gjithsej.
- Popullsia kosovare jeton më shumë në zonat rurale se sa zonat urbane. Struktura e popullsisë sipas tipit të vendbanimit është 55: 45%.
- Popullsia kosovare dëshmon së për cdo 100 lindje vajzash ka rreth 109 lindje djemsh.
- Jetëgjatësia shënon 71 vjet për femrat dhe 67 vjet për meshkujt.
- Mosha mesatare e martesës në vitin 2006 është 30 vjeç për burrat dhe 27 për gratë.
- Shkalla e analfabetizmit është tre herë më e lartë tek gratë. Në periudhat kohore 10 vjecare kjo tendencë ka mbetur gati e njëjtë, por vlerat absolute të analfabetizmit janë ulur në mes të dy regjistrimeve të popullsisë.
- Pjesëmarrja e grave në forcat e punës është gati sa gjysma e burrave. Në vite kjo përqindje është ulur nga 35 në 31 për gratë dhe nga 72 në 70 për burrat.
- Shkalla e papunësisë për vitin 2006 shënon 62% për gratë , ndërsa për burrat 35 %.
- Ndër profesionet që ushtrojnë gratë janë më shumë ato teknike të larta apo profesionale. Ndërsa burrat kryejnë gati të gjithat llojet e profesioneve.
- Gratë janë të punësuar më shumë në sektorët e bujqësisë, arsimit, tregtisë dhe shëndetësisë.
- Gratë zënë 29% të vendeve në parlament. Nga 10 komisione parlamentare, vetëm dy udhëhiqen nga femrat.pjesëmarrja e femrës në Kuvende Komunale sillet nga 22% deri në 28%.

Some important facts

Women and men should be visible in the statistics, therefore some data should be disaggregated by sex.

- Population of Kosovo is young; the proportion of persons aged 0-18 years is 46 percent.
- Population of Kosovo lives more in the rural areas than in urban areas. This proportion is shared 55: 45%
- During the last four years for each 100 girl's births in Kosovo there are 109 boy's births.
- Life expectancy at birth is 71 years for women and 67 years for men.
- Average age at marriage for 2006 is 27 years for women and 30 years for men.
- Illiteracy rate is three times higher among women. Meanwhile the absolute numbers of illiterate people are reduced; this tendency has remained unchanged during censuses period.
- The proportion of women in the labor force is quite half of men. During the last five years this percentage has been reduced from 35 to 31 for women and from 72 to 70 for men.
- Unemployment rate for women is 62 percent and for men is 35 percent.
- Women are working more at professional levels such as technicians or qualified jobs. Meanwhile men are doing all types of professions.
- Women are working more in the telecommunication, and in the public sector of education and health.
- Women have 29 percent of the parliamentary seats. The gender distribution at local government gives them 25 percent of the total representation.

MEKANIZMAT INSTITUCIONAL PËR ARRITJEN E BARAZISË
GJINORE NË NIVELIN QENDROR

- Agjensioni për Barazi Gjinore / ZKM
- Plani i Veprimit për Partneritet Evropian / PVPE
- Institucioni I Ombudspersonit – Njësia për Barazi Gjinore
- Zyrtaret / ët për barazi gjinore në ministri
- Këshilli Ndër– ministror për Barazi Gjinore
- Sektori për Çështje Gjinore – MAPL

MECHANISMS TO ACHIEVE THE GENDER EQUALITY IN
CENTRAL LEVEL

- Office of Gender Equality at the Prime Minister Office.
- The action Plan of European Partnership
- Ombudsman office – Gender Unit
- Civil servants on Gender Equality in central institutions
- Inter ministerial council on Gender Equality
- Unit for gender issues – MAPL

Lista e shkurtesave

ABESH....Anketa e Buxhetit të Ekonomive Shtëpiake
AESHB....Anketa e Ekonomive Shtëpiake Bujqësore
ADSHAnketa Demografike dhe e Shëndetit
AFPAnketa e Fuqisë Punëtore
DASHC...Departamenti i Administratës të Shërbimit Civil
ESK.....Enti Statistikor i Kosovës
MSHPMinistria e Shërbimeve Publike
MTIMinistria e Tregëtisë dhe Industrisë
ATAdministrata Tatimore

List of Abbreviations

AHS.....Agricultural Household Survey
DHS.....Demographic and Health Survey
DCSA.....Department of Civil Service Administration
HBSHousehold Budget Survey
LFSLabor Force Survey
MPS.....Ministry of Public Service
SOK..... Statistical Office of Kosovo
MTI Ministry of Trade and Industry
TA..... Tax Administration

Vdekjet Perinatale deri në 6 ditë

Vdejet Neonatale 7–27 ditë

Vdekjet Post-neonatale 28 ditë–1 vitë

Perinatal deaths..... up to 6 days

Neonatal deaths..... 7–27 days

Post-neonatal deaths 28 days–1 year

Përmbajtja – Table of contents

Gratë dhe pronësia	9
Pronësia mbi shëtpinë	10
<i>Women's property rights</i>	12
<i>Housing Titling</i>	14
Popullsia – <i>Population</i>	15
Arsimi - <i>Education</i>	30
Tregu i punës - <i>Labor market</i>	40
Punësimi – <i>Employment</i>	42
Papunësia - <i>Unemployment</i>	50
Niveli i jetesës - <i>Living conditions</i>	54
Femrat në vendimarrje – <i>Women in decision making</i>	57
Femrat në strukturat e mbrojtjes dhe të rendit – <i>Women in defense and order agencies</i>	60
Femrat në sistemin gjyqësorë - <i>Women in Juridical System</i>	60

Gratë dhe pronësia

Të drejtat e barabarta të grave për tokë, strehim dhe pronësi, janë pjesë e të drejtave të njeriut të njohura nga instrumente të ndryshëm ndërkombëtarë. Megjithatë, zbatimi i këtyre ligjeve dhe politikave për të bërë realitet të drejtat e grave për tokë dhe pronësi, mbetet një sfidë e madhe dhe kërkon përpjekje konkrete nga të gjitha nivelet.

Këto të drejta u bënë pjesë e rregullores 2001/9 të Kornizes Kushtetuese për vetëqeverisje të përkoheshme. Qeveria e Kosovës e konsideron si një nga objektivat strategjike të saj promovimin e të drejtave dhe pavarësisë ekonomike të grave, duke përfshirë aksesin në punësim, kushtet e përshtatshme të punës dhe kontrollin mbi burimet ekonomike. Nga pikëpamja legjislative janë ndërmarrë reforma legjislative dhe administrative për t'iu dhënë grave të drejta të barabarta me burrat në burime ekonomike, duke përfshirë aksesin në zotërimin dhe kontrollin e tokës dhe të formave të tjera të pronësisë, kredisë, trashëgimisë, burimeve natyrore dhe të teknologjisë së re të përshtatshme.¹

Globalisht që nga viti 1995, ka një rritje të ndërgjegjësimit dhe i është dhënë më shumë vëmendje politike kësaj çështje. Brenda vendit janë të nevojshme disa ndryshime që të sigurohet e drejta e pronësisë për gruan; si ndryshimi dhe harmonizimi i legjislacionit të detyrueshëm (statutory) dhe atij zakonor/zakonshëm (customary), promovimin e njohurive ligjore (legal literacy), duke mbështetur organizatat e grave të cilat mund t'i ndihmojë gratë të kenë pretendime për tokë dhe që

¹ Konferenca e Katërt Botërore e Kombeve të Bashkuara mbi Gratë, Beijing, Kinë – Shtator 1995, Plani i Veprimeve për Barazinë, Zhvillimin dhe Paqen.

mund të regjistrojnë pjesën e tokës, ose të pronësisë së grave. Në ato zona në të cilat po lëvizet drejt sistemeve të regjistrimit formal të tokës, e drejta e përbashkët mund të rrisë aksesin e grave për tokë, duke ndihmuar ofruar mbrojtje kundrejt vendimmarrjes 'tekanjoze' nga njëri prej bashkëshortëve dhe mbrojtjen kundër shpronësimit të grave për shkak të braktisjes, ndarjes apo divorcit.

Kjo reformë legjislative është shumë e re për Kosovën, por pavarësisht ky proces është lancuar në të gjithë vendin. Akoma ka shumë gjëra që duhen ndryshuar si në lidhje me zakonet e vjetra jetësore ashtu edhe me modernizimin e procedurave gjyqësore.

Gratë që zotërojnë pronësi, ose që kontrollojnë asete janë të pozicionuara më mirë për përmirësimin e jetës së tyre dhe për tu përballur me një krizë. Duke pasur në zotërim tokën dhe shtëpinë e tyre, ato janë drejtpërdrejtë përfituese të përfitimeve nga përdorimi i tokës dhe të të ardhurave më të larta, si edhe pasjen e një vendi të sigurtë për të jetuar. Zotërimi i aseteve nga gratë rritë statusin e tyre social dhe rolin vendimmarrës brenda familjes dhe komunitetit. Zotërimi, gjithashtu çon në përmirësimin e statusit të ushqyerjes së fëmijëve, arsimim më të lartë për vajzat dhe ndikime të tjera pozitive. Nga ana tjetër, mungesa e zotërimit të pronësisë, kontribuon në statusin e ulët social të grave dhe vulnerabilitetin e tyre ndaj varfërisë. Ajo është gjithashtu e lidhur ngushtësisht me problemet e lidhura me zhvillimin, duke përfshirë urinë, urbanizimin, migracionin dhe dhunën në familje.

Pronësia mbi shtëpinë

Pronësia mbi shtëpinë shpesh përdoret si një zgjidhje për të mbrojtur gratë nga mos pasja e titullit të pronësisë gjatë largimit, ndarjes apo divorcit si dhe fuqinë negociuese të gruas në momentet e vendim marrjes. Pronësia e detyrur mbi banesën gjatë martesës së çiftit është një nga të drejtat më të sigurta për gruan. Në Kosovë ka shumë pak burime informacioni që të lejojnë ta masësh këtë fenomen. Ne duke

marrë të dhënat e anketës së buxhetit të familjeve, kemi bërë një supozim që kryefamiljarët femra janë edhe pronare të shtëpisë. Të dhënat tregojnë:

Gjinia e kryefamiljarit sipas zotërimit të banesës

Head of household who owned a house according to gender

Gjinia / Gender	2005		2006	
	Total	%	Total	%
Meshkuj / Male	254 840	97.02	231 499	93.28
Femra / Female	7 819	2.98	16 679	6.72
Gjithësej / Total	262 659	100.00	248 178	100

Burimi: ABF, 2005, 2006

Source: HBS, 2005, 2006

Women's property rights

Women's equal rights to land, housing and property are human rights, recognized in various international human rights instruments.

Implementation of such laws and policies remains a huge challenge and require concerted efforts from all levels in order for women's rights to land and property to become reality.

These rights were included in the regulation 2001/9, Constitutional Framework on Interim Self-Government in Kosovo and detailed legislation part have been produced on that issue. The Kosovo Government considered as one of the strategic objectives to promote women's economic rights and independence, including access to employment, appropriate working conditions and control over economic resources. From the legal point of view there are undertake legislation reforms to give women equal rights with men to economic resources, including access to ownership and control over land and other forms of property, credit, inheritance, natural resources and appropriate new technology.

Globally since 1995, there has been growing awareness and policy attention to this issue. Within countries, several types of changes are necessary to ensure women's property rights: amending and harmonizing statutory and customary laws, promoting legal literacy, supporting women's organizations that can help women make land claims, and recording women's share of land or property. In areas that are moving toward formal land registration systems, joint titling can enhance women's access to land, helping to guard against capricious decision making by a spouse and protecting against the dispossession of women due to abandonment, separation or divorce.

This legislation reform in Kosovo was introduced very recently, but the process has been country wide spread. Still many things needed to

addressed to change all the old life style habits and juridical procedures.

The Convention on the Elimination of All Forms of Discrimination against Women defines sex-based discrimination as “any distinction, exclusion or restriction made on the basis of sex which has the effect or purpose of impairing or nullifying the recognition, enjoyment or exercise by women, irrespective of their marital status, on a basis of equality of men and women, of human rights and fundamental freedom in the political, economic, social, cultural, civil or any other field” (article 1)²

Women who own property or otherwise control assets are better positioned to improve their lives and cope should they experience a crisis. By owning their home and land, women directly gain from such benefits as use of the land and higher incomes as well as having a secure place to live. Women’s asset ownership has been found to enhance women’s social status and decision-making role within the household and community. It also leads to improved child nutritional status, higher education for girls and other positive impacts. The lack of property ownership, in contrast, has been found to contribute to women’s low social status and their vulnerability to poverty.

In Kosovo there are about 40 thousand Active Enterprises. They mostly are owned by man, women owned only 9,9 percent. The women presence is very high in trade and services such as health or education.

Very few businesses are run by women. Usually women are running mikrobusiness where the number of employess is less than five. Those types of business represent about 95% of total mikro enterprises.

² UN Treaty Series, vol. 1249, No. 20378.

Also available from


<http://www.un.org/womenwatch/daw/cedaw/text/econvention.htm>.

Housing Titling

Housing titling often is suggested as a solution to gender discrimination, protecting women against the dispossession through abandonment, separation or divorce; and increase women’s bargaining power in household decision making. Mandatory joint titling for legally married couples provides the most secure rights for women. In Kosovo there are few sources to measure statistically this situation. As there is a household budget survey running from some years now, there was made an assumption that for all those head of the household that owned the house, to see the difference between man and women. The data are as below.

Pronarët e bizneseve sipas gjinisë, 2006

Owners of business by sex, 2006



Burimi: MTI dhe AT

Source: MTI and TM

Popullsia – Population

Në mungesë të të dhënave për numrin e popullsisë në Kosovë, që nga regjistrimi i fundit i vitit 1981, Enti i Statistikës së Kosovës e pa si nevojë vlerësimin e popullsisë. Tabela në vijim paraqet vlerësimin e popullsisë për vitet 2002–2006. Vlerësimi është bërë në bazë të metodave statistikore për vlerësime, prognoza dhe projeksione. Në përlllogaritje u përdorën të dhëna që erdhën nga burimet administrative si dhe vlerësimet e bëra nga komisioni miksi vlerësimin të regjistrit civil të vitit 2000. Popullsia totale në Kosovë në fund të vitit 2006 është vlerësuar të jetë 2,100 000 banorë.

Due to the lack of data on the number of Kosovo population since the last census of 1981, the Statistical Office of Kosovo considered necessary to get the estimation of its population. The following table presents the population estimations for the period 2002–2006. The estimations were based on the statistical methods used for estimations, prognoses and projections. Data from administrative sources as well as the estimations done by mix commission of civil register assessment of 2000 were used to have these estimations available. The total population in Kosovo at the end of 2006 was estimated to be 2,100 000 inhabitants.

Popullsia totale në Kosovë (në mijë)

Total population in Kosovo (in 1000's)

Vitet Year	Popullsia gjithsej Total population	Gratë Women	Burrat Men
2002	1 985	982	1 003
2003	2 016	988	1 028
2004	2 041	1 004	1 037
2005	2 070	1 010	1 060
2006	2 100	1 039	1 060

Burimi: ESK, Departamenti i statistikave të popullsisë, (vlerësim)

Source: SOK, Department of population statistics (estimatet)

**Struktura gjinore e popullsisë bujqësore në komuna (%),
2005, 2006,**

Structure of agriculture population by municipalities (%), 2005, 2006

Komuna Municipality	2005		2006	
	Gratë Women	Burrat Men	Gratë Women	Burrat Men
Deqani	49	51	48	52
Gjakova	49	51	48	52
Gllgovci	50	50	48	52
Gjilani	49	51	49	51
Dragashi	48	52	47	53
Istogu	49	51	50	50
Kaqaniku	44	56	46	54
Klina	49	51	48	52
F.Kosova	45	55	47	53
Kamenica	47	53	47	53
Mitrovica	46	54	49	51
Leposaviqi	46	54	47	53
Lipjani	48	52	48	52
Novoberda	45	55	48	52
Obiliqi	48	52	46	54
Rahoveci	48	52	49	51
Peja	47	53	49	51
Podujeva	45	55	49	51
Prishtina	47	53	50	50
Prizreni	47	53	45	55
Skenderaj	45	55	49	51
Shtimja	48	52	49	51
Shterpca	47	53	47	53
Suhareka	47	53	47	53
Ferizaji	45	55	47	53
Vitia	46	54	49	51
Vushtrria	45	55	47	53
Z.Potoku	49	51	50	50
Zveqani	41	59	35	65
Malisheva	47	53	49	51
Kosova	47	53	48	52

Burimi: ESK, Anketa e ekonomive shtëpiake bujqësore


Source: SOK, Agricultural household survey

Të dhënat tregojnë se në popullsinë bujqësore në Kosovë, për cdo 100 gra ka mesatarisht 112 burra. Struktura gjinore nëpër komuna nuk është e njëjtë.

According to the data, there are in average 112 men per 100 women in Kosovo. The gender structure by municipalities is not the same.

Popullsia sipas grup-moshave (%), 2006

Population by age-groups (%), 2006



Burimi: ESK, AFP,

Source: LFS, SOK

Koeficientët total të fertilitetit të shprehur për gratë sipas grup-moshave dhe vendbanimit, 2003*Age total fertility rate for women by age-groups and residence, 2003*

Grupmoshat Age-group	Gjithsej Total	Vendbanimi - Residence	
		Urbane - Urban	Rurale - Rural
15-19	0,012	0,023	0,008
20-24	0,147	0,153	0,144
25-29	0,213	0,141	0,244
30-34	0,140	0,104	0,156
35-39	0,059	0,056	0,061
40-44	0,023	0,012	0,030
45-49	0,000	0,001	0,000
TFR	3,0	2,5	3,2

Burimi: ADSH


Source: DHS

Të dhënat nga tabela tregojnë se mesatarisht çdo nënë ka lindur tre fëmijë. Gratë në vendet rurale mesatarisht kanë nga 3.2 fëmijë për grua, kurse në vendet urbane 2.5 fëmijë për grua. Nëse fertiliteti në Kosovë do të jetë i pandryshuar, një grua kosovare do të lindë mesatarisht tre fëmijë gjatë jetës së saj.

Data in the table indicate that fertility rate is in average three children per mother. Women in the rural areas have an average of 3.2 children per mother, while in urban areas 2.5 children per mother. If the fertility rate remains the one and same woman will give birth to three children during her life.

Koeficientët total të fertilitetit të shprehur për gra sipas grup-moshave dhe vendbanimit, 2003

Total fertility rate for women by age-groups and residence, 2003



Burimi: ADSh

Source: DHS

Krahasimi i fertilitetit në zonat rurale dhe urbane në dy grupmoshat e para, 15–25 vjeç rezultojnë të ketë sjellje shumë të ngjajshme. Pas moshës 25 vjeç, lëvizja e dukurisë dallon shumë. Në zonat rurale fertiliteti rritet fuqimisht dhe arrin kulmin në mes të grup-moshave 25 dhe 29 vjeç, pastaj bie me shpejtësi. Fertiliteti në grup-moshën 30–34 vjeç tregon rënje të shprjtë dhe arrin fertilitetin e grup-moshës 20–24 vjeç. Në zonat urbane fertiliteti fillon të bie ngadalë dhe takohet me fertilitetin e zonave rurale në grup-moshën 35–39 vjeç.

The comparison of fertility rate in rural and urban areas in the age-group of 15–25 years old results almost the same. This phenomenon is different after the age of 25 years old. In the rural areas fertility rate has increased and reaches its peak among the age-group of 25–29 years old and then it decreases significantly. The fertility rate among the age-group of 30–34 years old indicates a fast decrease reaching the fertility rate of the age-group of 20–24

years old. With regard to the urban areas the fertility rate decreases slowly, while coming across with the fertility rate in the rural areas for the age-group of 35–39 years old.

Të lindur gjallë sipas gjinisë

Live births by sex

Vitet Year	Numri – Numbers		Në % – In %	
	Vajza Girls	Djem Boys	Vajza Girls	Djem Boys
2002	17 384	18 752	48	52
2003	15 217	16 777	48	52
2004	16 850	18 213	48	52
2005	17 787	19 431	48	52
2006	16 360	17 827	48	52

Burimi: ESK, Statistikat vitale

Source: SOK, Vital statistics

Raporti, femra, meshkuj në lindje nuk paraqet ndryshime të mëdha në vite. Popullsia kosovare në lindje vazhdon të dominohet nga meshkujt.

The male – female birth ratio does not represent big differences in years. Kosovo births rate continues to be dominated by males. At birth gender ratio favours males.

Lindjet e gjalla sipas komunave (numri), 2005 dhe 2006*Live births by municipalities (numbers), 2005 and 2006*

Komuna <i>Municipality</i>	2005		2006	
	Vajza <i>Girls</i>	Djem <i>Boys</i>	Vajza <i>Girls</i>	Djem <i>Boys</i>
Deçani	382	386	388	412
Gjakova	847	899	783	858
Glogovci	682	707	655	748
Gjilan	843	868	796	889
Dragashi	382	416	331	351
Istogu	281	322	317	355
Kaçaniku	556	636	701	691
Klina	438	488	453	469
Fushë Kosova	290	316	274	299
Kamenica	228	282	235	234
Mitrovica	771	840	684	734
Leposaviqi	2	0	1	2
Lipjani	560	627	580	616
Novobërda	16	17	17	16
Obiliqi	237	228	177	194
Rahoveci	723	822	600	722
Peja	774	841	728	826
Podujeva	1 012	1 147	927	923
Prishtina	1 594	1 832	1 557	1 740
Prizreni	1 896	2 155	1 465	1 576
Skenderaj	612	589	554	582
Shtime	270	284	307	305
Shtërpce	48	57	41	44
Suhareka	908	949	702	783
Ferizaj	1 153	1 221	1 073	1 206
Vitja	493	509	482	502
Vushtrria	715	801	659	734
Zubin Potoku	9	5	6	7
Zveçani	2	1	1	..
Malisheva	929	1 024	704	812
Jashtë Kosovës	134	162	129	137
Gjithsej / Total	17 787	19 431	16 360	17 827

Burimi: ESK, Statistikat vitale

Source: SOK, Vital statistics, 2005, 2006

Vdekjet sipas gjinisë, 2002–2006*Deaths by sex, 2002–2006*

Vitet Year	Numri - Numbers		Në % - In %	
	Gratë Women	Burrat Men	Gratë Women	Burrat Men
2002	2 306	3 348	41	59
2003	2 676	3 741	42	58
2004	2 745	3 645	43	57
2005	3 149	4 058	44	56
2006	3 166	4 313	42	58

Burimi: ESK, Statistikat vitale *Source: SOK, Vital statistics***Vdekjet e foshnjeve sipas gjinisë dhe moshës, 2002–2006***Infant deaths by sex and age-groups, 2002–2006*

Vitet Years	Gjinia Sex	Numri	Perinatale (%)	Neonatale (%)	Postnatale (%)
		Numbers	Perinatal (%)	Neonatal (%)	Postnatal (%)
2002	Vajza – <i>Girls</i>	205	60	15	25
	Djem – <i>Boys</i>	198	60	10	30
2003	Vajza – <i>Girls</i>	265	59	10	24
	Djem – <i>Boys</i>	199	63	13	26
2004	Vajza – <i>Girls</i>	233	66	10	24
	Djem – <i>Boys</i>	182	64	13	23
2005	Vajza – <i>Girls</i>	155	66	5	28
	Djem – <i>Boys</i>	202	62	8	30
2006	Vajza – <i>Girls</i>	174	64	13	23
	Djem – <i>Boys</i>	236	61	10	29

Burimi: ESK, Statistikat vitale

Source: SOK, Vital statistics

Vdekjet e foshnjave nën një vjeç, në një seri kohore të dhënash prej katër vjetësh, tregojnë se imuniteti i djemëve është më i ulët dhe nuk është stabil në krahasim me vajzat. Vdekjet rezultojnë të jenë më të

larta tek gjinia mashkullore. Por ende nuk ka mundësi për të thelluar analizat mbi këtë situatë, për sa kohë nuk përpunohet informacioni për vdekjet sipas shkaqeve.


In years, infant mortality of children less than one year old indicates that boy's immunity is lower and not stable compared to the girls. The deaths seem to be higher for males. But it is still not possible to deepen the analysis on this situation, due to the lack of analyses on causes of deaths.

Llojet e sëmundjeve ngjitëse sipas gjinisë, 2006*Categories of illnesses by sex, 2006*

Sëmundjet - Illness	Numri – Number		%	
	Gratë Women	Burrrat Men	Gratë Women	Burrrat Men
Sindromi i diuresë në gjak <i>Blood diarrhoea syndrome</i>	49	68	43	57
Paraliza akute flakcide (PAF) – FAP	2	-	100	-
Verëdhëza akute B <i>Acute hepatitis B</i>	94	58	62	38
Tularemia – <i>Tularemia</i>	58	47	55	45
Pertussis – <i>Pertussis</i>	33	35	49	51
Sëmundjet tjera ngjitëse <i>Other infectious diseases</i>	2 531	2 239	53	47
Sindromime ethe ekzantemetike – EFS	13	36	27	73
Parotiteti epidemik – <i>Epidemic mumps</i>	215	261	45	55
Tuberkulozi (TBC) – TBC	567	555	51	49
Skabiesti – <i>Scabbiest</i>	306	282	52	48
Dyshimi në influencë <i>Influenza ssuspicion</i>	8 965	8 694	51	49
Infektimet me parazit intestinal <i>Intestinal parasite</i>	148	128	54	46
Diarea acute – <i>Acute diarrhoea</i>	19 987	23 244	46	57
Variçela – <i>Varicoese</i>	2 013	2 837	42	58
ITPR-Pneumonia – <i>ITPR-Pneumonia</i>	7 102	9 384	43	57
Verëdhëza akute A – <i>Acute hepatitis A</i>	361	385	48	52
Bruceloza – <i>Brucellosis</i>	27	31	47	53
Sindromi meningjeal <i>Meningitis Syndrome</i>	385	893	30	70
Sindromi i etheve hemoragjike <i>Haemorrhagic Fever Syndrome</i>	2	3	40	60
AIDS – AIDS	-	2	-	100

Burimi: ESK, Statistikat e shëndetësisë

Source: SOK, Health Statistics

Kurorëzimet sipas moshës së burrit dhe gruas, 2006*Marriages classified by sex and age-groups, 2006*

Burimi: ESK, Statistikat vitale

Source: SOK, Vital statistic

Numri më i madh i martesave për gjininë femërore ndodh në grupmoshat 20–29 vjeç, ndërsa meshkujt 25–34 vjeç. Diferenca në moshë, midis burrit dhe gruas sipas viteve në momentin e martesës, gjatë këtyre viteve tregon të ketë luhajtje të vogla. Për vitin 2006, mosha mesatare e burrave dhe grave në momentin e martesës ka mbetur e njëjtë me atë të vitit 2005.

The largest number of marriages for women is for the age-group of 20–29 years old, and 25–34 years old for men. Age difference between men and women in years at the moment of marriage during these years indicates a low increase. The average age of men and women in the moment of marriage has remained the same as in 2005.

Kurorëzimet sipas përgatitjes shkollore të burrit dhe gruas, 2005 dhe 2006*Marriages classified by sex and education, 2005 and 2006*

Përgatitja shkollore <i>Level of education</i>	Gruas <i>Women</i>	Burrit <i>Men</i>	Gruas <i>Women</i>	Burrit <i>Men</i>
Pa shkollë / <i>No school</i>	168	55	137	40
Fillore e pakryer <i>Primary not finished</i>	412	195	345	115
Fillore / <i>Primary</i>	5 460	2816	4 907	2 282
E mesme / <i>Secondary</i>	8 362	10 902	8 956	11 575
E lartë / <i>Tertiary</i>	537	805	461	655
Fakulteti / <i>Faculty</i>	359	643	431	660
Panjohur / <i>Unknown</i>	434	316	588	498
Gjithsej / <i>Total</i>	15 732	15 732	15 825	15 825

Burimi: ESK, Statistikat vitale

Source: SOK, Vital statistics

Të dhënat tregojnë se gjatë lidhjes së martesës niveli i shkollimit të burrave për familje të re të krijuar është i barabartë ose më i lartë se i grave.

The data indicate that in the new families, with regards to the level of education men are better educated than women.

Kurorëzimet dhe shkurorëzimet, 2002–2006*Marriages and divorces, 2002–2006*

Vitet Years	Kurorëzime Marriages	Shkurorëzime Divorces
	Gjithsej / Total	Gjithsej / Total
2002	18 280	-
2003	17 034	-
2004	16 989	1 293
2005	15 732	1 445
2006	15 825	1 480

Burimi: ESK, Statistikat vitale

Source: SOK, Vital statistics

Viti 2005 dhe viti 2006 tregojnë se numri i shkurorëzime është në rritje. Megjithatë, kjo shifër është akoma larg realiteteve europiane. Edhe pse shkalla e shkurorëzimeve në vitin 2006 shënoi një vlerë prej 9 shkurorëzimesh për 100 martesë, ajo u rrit vetëm për 1.6%(0.2) në krahasim me vitin 2005.

For 2005 and 2006 the number of divorces is increasing. But this numbers are still far behind from the European realities. Even though the rate of divorces for 2006 indices a value of 9 divorces for 100 marriages compared to 2005 it increased only 1.6(0.2) percent.

Shkurorëzimet sipas moshës së burrit dhe gruas, 2005 dhe 2006*Divorces classified by sex and age-groups, 2005 and 2006*

Grupmosha Age-group	2005		2006	
	Gratë Women	Burrat Men	Gratë Women	Burrat Men
-20	28	5	33	7
20-24	307	136	324	127
25-29	319	318	361	359
30-34	329	354	305	374
35-39	219	313	210	299
40-44	138	179	127	181
45-49	67	82	57	74
50-54	23	35	31	26
55-59	10	12	21	17
60-64	2	3	6	8
65-	3	8	5	8
Gjithsej Total	1 445	1 445	1 480	1 480

Burimi: ESK, Statistikat vitale

Source: SOK, Vital statistics

Të dhënat tregojnë se numri më i madh i shkurorëzimeve në vitin 2005 ndodh tek çiftet që kanë 5–15 vjet martesë. Kjo tipologji nuk ruhet për vitin 2006. Gjatë këtij viti numri më i madh i divorceve ka ndodhur tek çiftet që kanë 5–9 vjet martesë. Qendrueshmeria e martesës për çiftet që kanë 5–9 vjet bashkëjetesë në vitin 2006 është ulur me 29 për qind në krahasim me vitin 2005.

The data shows a high number of divorces during 2005, for the marriages with 5 to 15 years of cohabitation. This typology is not the same for 2006. The number of divorces is highest among couples that have 5–9 years of cohabitation. According to the data the marriage stability is decreased by 29 percent in 2006 in comparison with the previous year.

Shpërndarja e ekonomive familjare sipas karakteristikave të kryefamiljarit (gjinia, vendbanimi dhe statusi martesor) (%), 2003

Distribution of the household unit according to the characteristics of the heads of households (gender, type of settlement and marital status) (%), 2003

Gjendja martesore <i>Family status</i>	Gjithsej – Total		Urbane – Urban		Rural – Rural	
	Gratë <i>Women</i>	Burrat <i>Men</i>	Gratë <i>Women</i>	Burrat <i>Men</i>	Gratë <i>Women</i>	Burrat <i>Men</i>
Beqar/e / Single <i>I/e martuar</i>	5,7	2,6	6,9	3,7	4,8	2,1
<i>Married</i>	27,6	93,3	12,7	92,5	38,7	93,6
I/e shkurorëzuar <i>Divorced</i>	1,6	0,3	3,4	0,2	0,2	0,4
<i>I/e ve / Widow</i>	65,1	3,8	77,0	3,6	56,3	3,9
Gjithsej / Total	100	100	100	100	100	100

Burimi: ADSH, 2003

Source: DHS, 2003


Sipas gjëndjes martesore të kryefamiljarit, vërehet se numri i ekonomive familjare me një anëtar (beqarë/e) është i vogël. Këto familje janë më të shpeshta në vendet urbane, në krahasim me ato rurale. Përqindja e kryefamiljarëve femra të veja, është veçanërisht e lartë (70.0% në vendet urbane dhe 56.3% në vendet rurale) si për zonat urbane ashtu edhe për zonat rurale. Përqindja e kryefamiljarëve meshkuj të vejë është e ulët si në vendet urbane (3.6%) ashtu edhe në vendet rurale (3.9%). Kjo tregon se fenomeni i rimartesës është më i lartë tek meshkujt e vejë se sa të vejat. Ky fenomen në të vërtetë ka lidhje me traditën historike të jetesës familjare kosovare, që rimartesën e meshkujve e konsideron si diçka të domosdoshme.

According to the marital status of the head of household it is noted that the number of families with one member – single person is low. These families are more frequent in urban areas than in rural ones. The percentage of widow female as the head of household is high in both areas, urban and rural (77. percent in urban areas and 56.3 percent in rural areas). Meanwhile the percentage of widower male head of household is lowers both in urban and rural areas (3.6 percent and 3.9 percent). This indicates that the phenomena of remarriage are higher for widowers than for widows. This phenomenon is linked with historical tradition of Kosovo living style, where the remarriage acts for men is considered as a necessity.

Arsimi – Education

Përfshirja e fëmijëve, nxënësve dhe studentëve sipas gjinisë dhe niveleve të ndryshme të shkollimit, 2005/2006

Participance of children, pupils and students by sex and levels of education, 2005/2006



Burimi: ESK, Statistikat e arsimit

Source: SOK, Education statistics

Numri i nxënësve dhe studentëve të diplomuar, 2004/05 dhe 2005/06*Number of Pupils and students graduated, 2004/05 and 2005/06*

Nxënës e studentë <i>Pupils and students</i>	2004–2005		2005–2006	
	Gratë/ <i>Women</i>	Burrat/ <i>Men</i>	Gratë/ <i>Women</i>	Burrat/ <i>Men</i>
Gjithsej <i>Total</i>	22 463	26 156	20 603	27 611
Nxënës që morën dëftesë lirimi - Ars. 9 vjeçar <i>Pupils basic 9 years education</i>	13 861	17 716	14 209	15 786
Nxënës që morën dëftesë pjekurie - Ars. Mesëm <i>Licensed secondary education</i>	8 602	8 440	9 067	10 270
Studentë të diplomuar <i>Graduated university</i>	-	-	1 352	1 556
Në % / In %	46	54	43	57

Burimi: ESK, Statistikat e Arsimit,

Source: SOK, Education statistics

Në përgjithësi në Kosovë, niveli i edukimit i meshkujve dhe femrave nuk është diskriminues. Si meshkujt dhe femrat edukohen gati barazisht. Në përgjithësi në Kosovë, meshkujt kanë pak më shumë vite shkollimi se sa femrat. Meshkujt janë prezent në nivelin më të lartë të arsimimit, atë universitar.

In Kosovo the educational level by gender is not discriminating any of the gender representative, both women and men in average are educated quite equally. Men have a slight advantage towards women. Usually the Kosovo's men attend the university studies more than women.

**Mësimdhënësit në arsimin 9 vjeçar, të mesëm dhe të lartë,
2004/2005, 2005/2006. Përqindja**

Teachers on basic and secondary education, 2004/2005; 2005/2006. In percentage

Mësimdhënësi <i>Teacher</i>	2004/2005			2005/2006		
	<i>Total</i>	<i>%</i>		<i>Total</i>	<i>%</i>	
		<i>Gratë Women</i>	<i>Burrat Men</i>		<i>Gratë Women</i>	<i>Burrat Men</i>
Mësimdhënëses në arsimin 9 vjeçar <i>Teachers in basic 9 years education</i>	18 168	38	62	16 705	39	61
Mësimdhënëses në arsimin e mesëm <i>Teachers in secondary school</i>	4 500	29	71	4 558	30	70
Mësimdhënëses në arsimin e lartë <i>Professors</i>	1 007	24	76	980	25	75

Burimi: ESK, Statistikat e arsimit


Source: SOK, Education Statistics

Popullsia 10 vjet dhe më shumë sipas të diturit e shkrim-leximit (në mijë), 1971, 1981 dhe 1991*Population 10 years and more by literacy knowledge (in 1000's), 1971, 1981 and 1991*

	1971		1981		1991	
	Gratë Women	Burrat Men	Gratë Women	Burrat Men	Gratë Women	Burrat Men
Gjithsej <i>Total</i>	424	438	546	581	703	748
Din shkrim-lexim <i>Literate</i>	242	348	402	527	575	704
Analfabet - <i>Illiterate</i>	181	91	144	54	128	45
% e analfabetëve <i>% of illiterate</i>	43	21	26	9	18	6

Burimi: ESK, Regjistrimi i popullsisë

Source: SOK, Population Census

Popullsia e moshës 10 vjet dhe më shumë sipas të diturit shkrim-lexim*Population 10 years and more by illiteracy knowledge*

Burimi: ESK, Regjistrimi i popullsisë

Source: SOK, Population Census

Analfabetët sipas gjinisë dhe grupmoshave (%), 2003

Illiterate by sex and age-groups (%), 2003


Grupmoshat Age-groups	Gjithsej Total	Gratë Women	Burrat Men
Gjithsej / Total	8	13	3
15-24	1	2	1
24-34	2	2	1
35-44	4	7	1
45-54	5	10	1
55-64	14	24	4
64-	50	72	25

Burimi: ADSH

Source: DHS

Analfabetët sipas gjinisë grup-moshave (%) 2003

